



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**  
**Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve**  
**Sektori i Transparencës dhe Komunikimit**

**Lënda :** *Minutat e takimit për draft vendimin e Këshillit të Ministrave “Për tarifat e përdorimit të faunës së egër”*

Ditën e premte datë, 10.07.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për draft vendimin e Këshillit të Ministrave “Për tarifat e përdorimit të faunës së egër”

Në këtë takim merri pjesë:

Z. Gëzim Shehu, përfaqësues i Federatës Rajonale të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunalë;

Znj. Elvana Ramaj Përgjegjëse Sektori, Drejtoria e Biodiversitetit;

Znj. Edlira Dersha, specialiste, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Z. Ermal Halimi, specialist, Drejtoria e Biodiversitetit;

Znj. Edit Verdhami, specialiste, Drejtoria e Biodiversitetit;

Z. Fludian Çuka, specialist, Drejtoria e Biodiversitetit.

Dëgjesa u hap nga znj. Elvana Ramaj, e cila shpjegoi se ky projekt vendim është hartuar në përmbushje të ligjit “Për Mbrojtjen e Faunës së Egër”.

Në Ministrinë e Mjedisit ka pasur në mënyrë të vazhduar kërkesa nga persona që duan ta shfrytëzojnë faunën e egër (i) për qëllime shkencore, kulturore dhe edukimi; (ii) për koleksione zoologjike; si dhe (iii) për përfitimin e produkteve jetësore ose për përdorimin e veprimtarive të tyre jetësore.

Znj. Ramaj shpjegoi se vlera e tarifave është përcaktuar jo vetëm në bazë të llogaritjeve, por duke parë dhe kuotimin në vendet e rajonit. Gjithashtu theksoi se nga tarifat e përcaktuara janë përjashtuar kategoria e nxënësve.

Z. Shehu pyeti nëse lejohej përdorimi i faunës së egër në të gjitha kategorizimet e Zonave të Mbrojtura.

Znj. Ramaj informoi se tashmë zonat e mbrojtura nw Shqipwri kanë struktura të dedikuara siç janë strukturat lokale tw Agjensisw Kombwtare tw Zonave tw Mbrojtura , gjë që ndihmon në procesin e kontrollit.

Të pranishmit u informuan, se nëse do kenë komente, mund t'i dërgojnë ato brënda një jave në adresën elektronike të Ministrisë së Mjedisit [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al).